

THE KOSOVO BANKER

Intervistë ekskluzive me UD.Guvernator Z. Fehmi Mehmeti

Platformat digjitale e pagesave dhe zëvendësimi i parës së gatshme

E-drejta për pagesa elektronike dhe reduktimi i parës së gatshme si instrument pagese

Suedia, vendi i parë që do të heqë parën e gatshme nga përdorimi?!

Digjitalizimi - përgatitja për të ardhmën

Reduktimi i Transaksioneve me para të gatshme Mundësitë dhe Sfidat



Depozita më e re ka emrin RRITA


Fito deri në
3.75%



038 666 666 | www.bkt-ks.com

Depozitë me interes që rritet çdo vit

Norma efektive e interesit e njëjtë me normën vjetore



IMPRESSUM

BORDI I DREJTORËVE TË SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS



Z. Ilir I. Aliu
Kryetar i Bordit,
ProCredit Bank



Z. Robert Wright
Zv. Kryetar i Bordit,
Raiffeisen Bank



Znj. Merita Gjyshinca-Peja
Banka Ekonomike



Z. Abdurrahman Balkiz
Banka Kombëtare
Tregtare



Z. Arton Celina
Banka për Biznes



Z. Alper Karakoç
IS Bank



Z. Lavdim Koshutova
NLB Prishtina



Z. Orcun Ozdemir
TEB Bank



Z. Meriton Sunduri
Ziraat Bank

DREJTOR EKZEKUTIV I SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS DHE KRYEREDAKTOR:

Z. PETRIT BALIJA

U.D. ZYRTARE E KOMUNIKIMIT DHE REDAKTORE:

ZNJ. BLINA ZHUBI



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK)

bankare në Republikën e Kosovës. SHBK është përfaqësuese e bankave komerciale të Kosovës, anëtare të SHBK, në lidhje me çështjet sektoriale bankare dhe bashkëpunon me të gjitha autoritetet përfshirë Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë, Bankën Qendrore, Institucionet Financiare Nderkombetare, Mediat, etj, me qëllim mbështetjen e stabilitetit dhe zhvillimit të sektorit bankar në Kosovë.

"The Kosovo Banker" është botim i Shoqatës së Bankave të Kosovës. Botohet dy herë në vit, me qëllim të informimit të saktë të publikut lidhur me industrinë bankare në Kosovë. Shoqata e Bankave të Kosovës; Rr. Lidhja e Pejës p.n, Zona Industriale, Prishtinë; 10000. Republika e Kosovës; +381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com.

THE KOSOVO BANKER
MBËSHKETET NGA FONDI
EVROPIAN PËR EVROPËN
JUGLINDORE -DEPARTAMENTI
PËR ZHVILLIM (EFSE-DF)



EUROPEAN FUND FOR SOUTHEAST EUROPE
DEVELOPMENT FACILITY

PËRMBAJTJA

EDITORIALI 1

1.0 SEKTORI FINANCIAR 3

- Intervistë me UD Guvernatorin - **Fehmi Mehmeti**
- Platformat digjitale të pagesave dhe zëvendësimi i parasë së gatshme - **Eriola Bibolli**

2.0 KËNDI I EKSPERTËVE 14

- E-drejta për pagesa elektronike - **Boryana Ivanova Mustafa**
- Digjitizimi - përgatitja për të ardhmen - **Katerina Boshevska**
- Trendet, ndryshimet dhe rritja e pagesave përmes platformes digjitale - **Afrim Gërguri**

3.0 EKONOMI 23

- Të bërit biznes 2018: Kosova në mesin e dhjetë reformatorëve në botë
- Reduktimi i ekonomisë së errët nëpërmjet pagesave elektronike

4.0 KËNDI I EDUKIMIT FINANCIAR 28

- Kosova Nikoqire e Konferencës Rajonale për Edukim Financiar

- Suedia, vendi i parë që do të heqë paratë nga përdorimi!
- Cili është dallimi në mes kartelës debit dhe kartelës kredit?

5.0 LAJMET E SHBK-SË 32

- SHBK merr mirënjohje për kontribut të veçantë në fushën e edukimit financiar
- Shoqata e Bankave mbledhë gazetarët e fushës së ekonomisë
- SHBK dhe BQK mbajtën takimin e dytë gjashtëmuor për vitin 2017
- U mbajtë trajnimi “Financimi i NVM-ve: Strategjia dhe Organizimi i Bankave”

6.0 BANKAT FUQIZOJNË SHOQËRINË 35

- Banka Ekonomike dhuron Donacion për QKUK
- Banka ProCredit, partner shumëvjeçar i Dokufest
- TEB Banka ofron shërbime jofinanciare për klientët e saj
- Projektet e përkrahura nga Banka Raiffeisen

Deklarim i përgjegjësisë: Pikëpamjet e shprehura në shkrimet e revistës janë ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet apo politikat e Shoqatës së Bankave të Kosovës (SHBK) dhe Fondit Evropian për Evropën Juglindore -Development Facility (EFSE-DF). SHBK dhe EFSE-DF nuk mbajnë përgjegjësi mbi përmbajtjen e artikujve të autorëve të publikuar në revistën “The Kosovo Banker”.



A është sukseesi
çështje që
lidhet me fluksin
e parasë?

Apo çështje
idesh?



Një kompani e suksesshme ka nevojë për të dyja: qetësi për të llogaritur dhe pasion për çështjen në dorë. Ky besim reflektohet në parimin tonë udhëheqës: 'EOS. Me mendje dhe zemër në financë'. Ky parim na shoqëron në punën tonë për kompaninë tuaj. Shërbimet tona minimizojnë nivelin tuaj të rrezikut ndaj mospagimit të kësteve, duke përmirësuar fluksin e të hollave tuaja. Kjo do të thotë se ju përfitoni nga rritja e sigurisë, keni më shumë burime për ide të reja dhe ruani suksesin në terma afatgjatë. Më shumë informacione mbi shërbimet tona mund të gjeni në **www.eos-solutions.com**

EDITORIAL

Duke shikuar drejt vitit 2018 dhe në prag të përvjetorit të 10 jubilar të Pavarësisë së Republikës së Kosovës, kujtojmë shumë nga të arriturat por edhe sfidat që po i lëmë mbrapa në vitin 2017.

Sektori bankar shënoj edhe një vit të ngarkuar me angazhime dhe sfida por një vit i cili korrë suksese të shumta dhe vendos sektorin bankar të Kosovës në një pozicion që është për aspiratë të shumë vendeve të rajonit. Të gjithë indikacionet tregojnë se sektori bankar në Kosovë është menaxhuar mirë duke prodhuar një portofol të shëndetshëm të kredive pa probleme me vetëm 3.6% të kredive jo-performuese dhe njëkohësisht duke luajtur një rol të pazëvendësueshëm në zhvillimin ekonomik duke zgjeruar kreditimin me mbi 10%.

Bankat financuan afër 1 miliard euro kredi të reja gjatë vitit që lamë pas duke mundësuar bizneseve që të zgjerojnë aktivitetet e tyre dhe të rrisin punësimin, qytetarët që të realizojnë qëllimet e tyre, si dhe buxhetit shtetërorë për të plotësuar nevojat buxhetore përmes letrave me vlerë. Bankat komerciale të Kosovës po bartin rolin kryesorë në zhvillimin ekonomik dhe facilitimin e qarkullimit të kapitalit në vend me një kosto mjaft të favorshme kur kemi parasysh se norma

**Dr. sc. PETRIT
BALIJA**

DREJTOR
EKZEKUTIV

SHOQATA E
BANKAVE TË
KOSOVËS



mesatare e interesit për kredi tani ka rënë në vetëm 6.5% (6.0% për ndërmarrjet).

Në aspektin e përgjithshëm socio-ekonomik, gjatë vitit që po lëm pas u shënuan shumë të arritura për Kosovën dhe qytetarët e saj e në veqanti për bizneset e Kosovës, por për shkak të sfidave të shumta të cilat dominuan këtë vit, disi këto të arritura mbeten të zbehta në sfondin e aspiratave për të arritur më shumë në vitin 2018. Ky edicion trajton një nga këto aspirata të cilat do të reformojnë ekonominë e vendit në mënyrë substanciale dhe shumë konkrete, respektivisht temën **Redukimi i Transaksioneve me Para të Gatshme.**

Një prej problemeve kyçe që kanë karakterizuar ekonominë e Kosovës gjatë këtyre 10 viteve të ndërtimit të kapaciteteve shtetërore, është

informaliteti në ekonomi i cili, sipas raporteve të fundit, vlerësohet të jetë afër 31.7%. Informaliteti ekonomik sjell një sërë problemesh në ekonominë e një vendi përfshirë këtu konkurrencën e pandershme, evazionin e tatimeve dhe taksave, punësimin pa kontrata të punës, shitjen e produkteve nën standarde, etj. Një zgjidhje efektive për këtë problem ekonomik të vendit është reduktimi i përdorimit të parasë së gatshme, temë e cila është përzgjedhur për këtë edicion të revistës The Kosovo Banker.

Reduktimi i përdorimit të parasë së gatshme mund të bëhet përmes promovimit të shërbimeve elektronike bankare me theks të veçantë në kryerjen e transfereve përmes llogarisë bankare në internet e njohur si online banking si dhe përmes përdorimit të kartelës bankare të njohur si debit kartele për transaksionet e përditshme. Kalimi në transaksione bankare nga transaksionet me kesh sjell edhe të mira tjera për qytetarët e vendit duke përfshirë lehtësinë e transaksioneve, sigurinë e parasë së kursyer, menaxhim më të lehtë të buxhetit, si dhe shmangëjen nga mashtrimet me para të falsifikuara.

Në këtë edicion kemi nderin të shpalosim një intervistë ekskluzive me u.d. Guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës z. Fehmi Mehmetin i cili ka

ndarë me ne informacionet më të reja nga kjo fushë. Ky edicion gjithashtu sjell artikuj nga përfaqësues të rëndësishme të sektorit financiar dhe ekspert të fushës të cilët kanë shprehur pikëpamjet e tyre në lidhje me këtë temë. Për më shumë ky edicion sjell edhe aritkuj për edukim financiar si dhe lajme dhe ngjarje të rëndësishme nga sektori bankar i Kosovës. The Kosovo Banker vazhdon të mbetet një burim i rëndësishëm i informacionit për sektorin financiar dhe një dritare e edukimit financiar për qytetarët e Kosovës me mbi 10,000 kopjet në çdo edicion të shpërndara në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Duke falënderuar Bankat Komerciale të Kosovës dhe EFSE –Departamenti për Zhvillim, si dhe të gjithë autorët që kontribuan në realizimin e këtij edicioni, ju uroj lexim të këndshëm dhe punë të mbarë në vitin 2018! **Njëherit ju uroj të gjithëve përvjetorin e 10 jubilar të Pavarësisë së Republikës së Kosovës!**

Të nderuar lexues,

Petrit Baliça

Drejtor Ekzekutiv
Shoqata e Bankave të Kosovës

REDUKTIMI I TRANSAKSIONEVE ME PARA TË GATSHME

Mundësitë dhe Sfidat

SHBK: Sipas të dhënave të BQK-së, si kanë lëvizur trendët në transaksionet me para të gatshme dhe ato elektronike viteve të fundit?

Z.Mehmeti: Një ndër objektivat parësore të BQK-së është edhe mirëmbajtja e një sistemi efikas, të sigurt dhe të qëndrueshëm të pagesave në vend, si shtyllë kyçe e infrastrukturës financiare dhe ekonomisë së vendit. Në funksion të përmbushjes së këtij objekti, Banka Qendrore është e angazhuar në vazhdimësi në avancimin e infrastrukturës financiare, për të zhvilluar transaksionet elektronike në mënyrë që të reduktohen transaksionet në para të gatshme.

Në Kosovë viteve të fundit vërehet një rritje e përdorimit të instrumenteve elektronike për kryerjen e pagesave. Nga të dhënat e fundit statistikore, vërehet rritje në numër dhe vlerë të kredit transfereve, të cilat paraqesin një alternativë për kryerjen e pagesave pa para të gatshme. Me rritje të dukshme të përdorimit janë karakterizuar edhe pagesat përmes instrumenteve elektronike siç janë: transaksionet përmes debit kartelave, kredit kartelave dhe e-bankingut, duke ndikuar në zvogëlim të pagesave në para të gatshme.

Përdorimi i shërbimit e-banking gjatë viteve të fundit ka shënuar një rritje të dukshme. Numri i klientëve që përdorin llogaritë e tyre për pagesa përmes internetit, raportuar për muajin shtator 2017 është 320,314 llogari, dhe ky numër është rritur me mbi 40% krahasuar me vitin e kaluar.

Numri i përgjithshëm i llogarive bankare në fund të muajit shtator 2017 ishte 1.95 milionë, nga të cilat sipas të dhënave të raportuara nga bankat komerciale 16.4 % prej tyre janë të qasshme përmes internetit.

Sa i përket numrit dhe vlerës së transaksioneve ndërbankare të realizuara me shërbimin e-banking, vërehet një trend

**Z. FEHMI
MEHMETI**

UD GUVERNATOR I
BANKËS QËNDRORE



rritës i transaksioneve të iniciuara përmes internetit kundrejt atyre në formë letër. Nga numri i përgjithshëm i kredit transfereve të realizuara gjatë periudhës janar- shtator 2017, shihet se 9.04% e tyre janë iniciuar në formë elektronike, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2016, pjesëmarrja e tyre ishte 7.99% nga numri i përgjithshëm i kredit transfereve. E njëjta gjë mund të konstatohet edhe për vlerën e transaksioneve të iniciuara në mënyrë elektronike, ku gjatë kësaj periudhe të vitit 2017, 29.93% e vlerës së transaksioneve janë realizuar në formë elektronike, ndërsa në periudhën e njëjtë të vitit 2016 pjesëmarrja e vlerës së transaksioneve të realizuara në mënyrë elektronike ishte 22.41% nga vlera e përgjithshme e tyre.

Gjithashtu, sa i përket transaksioneve përmes instrumenteve të pagesave elektronike, sipas të dhënave të fundit të raportuara nga bankat komerciale në Bankën Qendrore, numri i përgjithshëm i kartelave në dispozicion të klientëve në fund të muajit shtator 2017 ishte 1,046,268 kartela, nga të cilat kartela me funksion debiti ishin 886,001 ndërsa kartela me funksion krediti 160,267.

Nëse bëhet një krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, vërehet se numri i përgjithshëm i kartelave është rritur për 6%. Rrjedhimisht, edhe transaksionet përmes instrumenteve të pagesave elektronike kanë një trend rritës përgjatë viteve të fundit.

Numri i transaksioneve me kartela për muajin e fundit raportues, pra për muajin shtator, ishte rreth 1,8 milion transaksione të cilat përfshijnë tërheqje dhe depozitime në terminale ATM dhe pagesat në terminale POS. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ka pasur rritje prej 5.5% të numrit të transaksioneve.

Rritje vërehet edhe në vlerën e transaksioneve të realizuar me kartela, ku gjatë muajit shtator 2017 vlera e transaksioneve ishte 247,9 milion euro dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2016, kemi rritje prej 11.8% të vlerës së transaksioneve. Sa i përket transaksioneve me kartela, mund të cekim gjithashtu edhe blerjet "online" me kartela që viteve të fundit janë bërë shumë atraktive për qytetarët e Kosovës. Këto pagesa janë duke u shoqëruar me trende të shpejta zhvillimi. Këto transaksione kryesisht përdoren për blerje të mallrave apo shërbimeve, rezervime të hoteleve, pagesa të biletave për udhëtime etj.

Nëse bëhet një krahasim me vendet e rajonit, për sa i përket përdorimit të kartelave, sipas të dhënave të publikuara në fund të vitit 2016, Kosova ka pasur në dispozicion 484,021 debit kartela për 1 milionë banorë, përderisa Shqipëria p.sh. në të njëjtën periudhë ka raportuar 301,596 debit kartela për 1 milionë banorë, kurse Maqedonia 697,112 debit kartela për 1 milionë banorë.

Numri i përgjithshëm i llogarive bankare në fund të muajit shtator 2017 ishte 1.95 milionë, nga të cilat sipas të dhënave të raportuara nga bankat komerciale 16.4 % prej tyre janë të qasshme përmes internetit.

Sa i përket kartelave me funksion krediti për vitin 2016 në Kosovë kanë qenë 88,382 për 1 milionë banorë, në Shqipëri 29,736 kredit kartela për 1 milionë banorë, ndërsa në Maqedoni janë raportuar 181,475 kredit kartela për 1 milionë banorë.

Nga të dhënat e lartcekura shihet se Kosova ka një trend në rritje të numrit të kartelave në përdorim dhe numrit të transaksioneve përmes instrumenteve të pagesave elektronike, e cila në disa kategori qëndron më lartë se disa prej vendeve të rajonit, megjithëse është e nevojshme të bëhet më tepër në zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme dhe shfrytëzimin e instrumenteve të pagesave elektronike për të ndjekur standardet e vendeve të BE-së.

SHBK: Cilat janë përparësitë e reduktimit të transaksioneve në para të gatshme për akterët e ndryshëm në ekonominë e Kosovës, përfshirë agjentët publik, bankat komerciale, bizneset si dhe individët?

Z.Mehmeti: Përdorimi dhe menaxhimi i parave të gatshme ka një kosto të lartë për të gjitha këto kategori që ju i cekët. Kjo për faktin se menaxhimi i parasë së gatshme ka koston e vet për ndërtimin e infrastrukturës fizike dhe angazhimin e personelit, gjithashtu koston e sigurimit të nevojshëm, të cilat paraqesin një kosto relativisht të lartë, por njëkohësisht bartin një rrezik të lartë për të gjitha palët që përdorin paratë e gatshme. Prandaj, zvogëlimi i përdorimit të parave të gatshme, përveç se rritë efikasitetin përmes uljes së kostove në fjalë zvogëlon rrezikun që bart përdorimi i parave të gatshme, si nga vjedhja, sulmet fizike të mundshme, rrezikun nga mashtrimet me kartëmonedha të falsifikuara etj.

Studimi i kryer nga Moody's, mbi ndikimin e pagesave elektronike në rritjen ekonomike, i publikuar në shkurt 2016, i cili ka përfshirë kartat e debitit, kreditit dhe kartat me parapagim, ka paraqitur se rritja e pagesave elektronike ndikon direkt në rritjen e konsumit dhe PBB-së. Për më tepër ky ndikim rritet vazhdimisht me rritjen e penetrimit të pagesave elektronike. Për të gjitha tregjet dhe ekonomitë e analizuara është vërejtur një korrelacion pozitivë ndërmjet përdorimit të kartelave dhe rritjes ekonomike. Nga ky studim është vlerësuar se me rritjen e pagesave elektronike rritet edhe eficienca ekonomike, pasi që zvogëlohen kostot e transaksioneve dhe përmirësohet rrjedha ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.



Sistemet e zhvilluara të pagesave elektronike kanë ndikim të madh edhe në rritjen e transparencës dhe fuqizimin e mekanizmave të monitorimit të sistemeve të taksave. Në këtë drejtim, një ndër përparësitë kryesore të reduktimit të transaksioneve në para të gatshme është edhe zvogëlimi i siç njihet “ekonomisë jo-formale” e cila ka pasoja të mëdha negative për ekonominë e një vendi. Këto pasoja kryesisht mund të përmbledhen në zvogëlimin e bazës së tatimit, zvogëlimin e kualitetit dhe kuantitetit të produkteve dhe shërbimeve për publikun, dëmtimin e konkurrencës së drejtë të tregut, degradimin e institucioneve ekonomike dhe sociale, rrjedhimisht ndikimin direkt në kufizimin e rritjes ekonomike të një vendi. Prandaj, është shumë me rëndësi për të gjitha këto kategori, si individët, bizneset, bankat dhe institucionet shtetërore që të punojnë në zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme dhe të avancojnë më tutje me rritjen e përdorimit të pagesave përmes instrumenteve elektronike.

Një ndër mënyrat kryesore për të avancuar në këtë drejtim është edhe zhvillimi i mëtejshëm

i infrastrukturës financiare, inkurajimi i inovacioneve të reja në fushën e shërbimeve të pagesave elektronike dhe promovimi i rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave.

Numri i përgjithshëm i kartelave në dispozicion të klientëve në fund të muajit shtator 2017 ishte 1,046,268 kartela, nga të cilat kartela me funksion debiti ishin 886,001 ndërsa kartela me funksion krediti 160,267.

SHBK: Në disa vende të BE-së ekzistojnë kufizime sa i përket vlerave maksimale të transaksioneve në para të gatshme. A ka kufizime të tilla në Kosovë të cilat rregullohen me ndonjë kornizë ligjore sa i përket transaksioneve në para të gatshme dhe njëherit a pritet të ketë ndonjë të tillë në vitet në vijim?

Z.Mehmeti: Pavarësisht se në shumë prej vendeve të BE-së ekzistojnë kufizime sa i përket vlerave maksimale të transaksioneve në para të gatshme, ende nuk ka një qëndrim të unifikuar të kuadër të BE-së sa i përket kësaj çështje. Megjithëse së fundi, kryesisht si rezultat i sulmeve të fundit terroriste në disa vende të BE-së dhe nevojave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ka pasur disa zhvillime për të unifikuar aplikimin e mundshëm të një kufizimi të tillë në nivel të BE-së. P.sh., së fundi në Francë, në vitin 2015, kufizimi në transaksionet në para të gatshme ndërmjet bizneseve dhe transaksioneve në para të gatshme ndërmjet konsumatorëve dhe bizneseve, është zvogëluar në 1,000 euro nga 3,000 sa ka qenë më herët, apo rasti i Spanjës e cila gjithashtu ka ndjekur Francën përmes aplikimit të kufizimit prej 1,000 eurove. Përderisa në vendet tjera, si Gjermania dhe Austria ende nuk ka një kufizim të tillë, dhe përpjekja e fundit për të iniciuar një kufizim të ngjashëm është ballafaquar me një reagim të madh të publikut.

Gjithashtu, Banka Qendrore e Evropës ka paralajmëruar se duke filluar nga pjesa e dytë e vitit 2018 do të ndaloj së emetuari kartëmonedhën 500 euro në mënyrë që të ndikoj në zvogëlimin e mundësisë dhe lehtësisë së përdorimit të parave të gatshme të vlerave të larta për kryerjen e transaksioneve. Megjithatë, kartëmonedhat 500 euroshe aktuale, do të vazhdojnë të mbesin në qarkullim pa asnjë kufizim.

Në Kosovë aktualisht, për sa i përket transaksioneve në para të gatshme ndërmjet bizneseve, Administrata Tatimore ka aplikuar kufizimin prej 500 eurove, përderisa nuk ka ndonjë kufizim për transaksionet ndërmjet personave fizik dhe bizneseve. Gjithashtu, ka një kërkesë për njoftim të NJIF për transaksionet mbi 10,000 euro dhe për deklarimin e burimit në rastet e deponimit të shumave mbi 10,000 euro, por edhe kërkesa për shpalosjen në rastet e bartjes së shumave mbi 10,000 euro në para të gatshme në hyrje / daljet jashtë Kosovës. Edhe legjislacioni aktual i BQK-së ka kufizuar shpërndarjen e mjeteve të kredive në shuma mbi 10,000 nga llogaria e kredimarrësit, ku mjetet mbi

10,000 duhet të shpërndahen vetëm përmes transfereve bankare të mbështetura me dokumente valide.

Vlen të theksohet se në disa raste sikurse është p.sh., Britani të Madhe dhe vendet skandinave, edhe pse nuk është aplikuar ndonjë kufizim i tillë, këto vende janë në krye të listës së vendeve për përdorim të ulët të parasë së gatshme dhe për përdorimin më të lartë të instrumenteve të pagesave elektronike. Kjo nënkupton se ka edhe shumë metoda dhe incentivave tjera të cilat mund të përdoren në funksion të rritjes së përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike. P.sh., shumë vende kanë vendosur si strategji të tyre kombëtare zvogëlimin e përdorimit të parave të gatshme, prandaj janë fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës financiare përmes investimeve në teknologji, kanë zhvilluar infrastrukturën ligjore për të krijuar hapësirë për shërbime të reja inovative, si dhe kanë krijuar incentiva përmes instrumenteve tatimore për përdoruesit e instrumenteve të pagesave.

Aplikimi i këtyre metodave tjera përveç kufizimit të vlerave maksimale të transaksioneve në para të gatshme, vlerësoj se duhet të merret parasysh sidomos në vendet të cilat janë të bazuara kryesisht në përdorimin e gjerë të parasë së gatshme, të cilat duhet të aplikojnë politika graduale në ndryshimin e aplikuar në mënyrë që të eliminohet mundësia e ndikimit negativ në rast të aplikimit të limiteve të tilla.

SHBK: Cili është roli i BQK-së dhe Bankave Komerciale, respektivisht, në angazhimet për reduktimin e transaksioneve në para të gatshme?

Z.Mehmeti: Vlerësoj se zvogëlimi i përdorimit të parasë së gatshme dhe rrjedhimisht zvogëlimi i ekonomisë jo-formale duhet të jetë strategji e nivelit kombëtar për të cilën duhet të angazhohen të gjitha institucionet e shtetit, megjithatë Banka Qendrore si rregullator dhe mbikëqyrësi i vetëm i sektorit financiar, së bashku me bankat komerciale si akterët kryesor në ofrimin e shërbimit të pagesave, kanë një rol kyç në reduktimin e transaksioneve në para të gatshme.

Një ndër çështjet më bazike është ofrimi i një infrastrukture të sigurve, të qëndrueshme dhe efikase për kryerjen e pagesave, për çfarë vlerësoj se është punuar shumë gjatë kësaj periudhe, falë angazhimit të Bankës Qendrore, por edhe duke ju falënderuar bashkëpunimit të ngushtë me bankat dhe me të gjithë akterët relevantë në këtë fushë.

Banka Qendrore nga korriku i vitit 2016 ka aktivizuar sistemin e ri të pagesave ndërbankare, përmes të cilit mundësohet kryerja e pagesave të shumave të mëdha, mbi 10,000 euro në kohë reale, i njohur si moduli "RTGS", gjithashtu ka avancuar sistemin e pagesave të transaksioneve me vlera të vogla të cilat kryhen përmes modulit të njohur si "ACH" përgjatë tri sesioneve ditore. Ky ka qenë një hap i rëndësishëm në avancimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave për sa i përket sigurisë, shpejtësisë dhe efikasitetit në kryerjen e shërbimit të pagesave ndërbankare, në pajtim me standardet ndërkombëtare. Sistemi i ri i pagesave është i projektuar sipas standardeve më të reja ndërkombëtare për fushën e sistemeve të pagesave (ISO 20022) dhe teknologjisë më bashkëkohore.

Për të gjitha tregjet dhe ekonomitë e analizuara është vërejtur një korrelacion pozitivë ndërmjet përdorimit të kartelave dhe rritjes ekonomike. Nga ky studim është vlerësuar se me rritjen e pagesave elektronike rritet edhe eficientia ekonomike, pasi që zvogëlohen kostot e transaksioneve dhe përmirësohet rrjedha ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.

Njëkohësisht, duhet të theksohet fakti që Banka Qendrore ka adaptuar dy skema të rëndësishme për lehtësimin e shërbimit të pagesave, siç janë skema KosGIRO dhe skema e Debitimit Direkt. Me anë të këtyre skemave ju është mundësuar kompanive, por edhe klientëve të kryejnë pagesat e tyre sipas standardeve të njohura ndërkombëtare,

me që rast është unifikuar faturimi i shërbimeve. Gjithashtu, është mundësuar automatizimi i pagesës së faturave përmes skemës së Debitimit Direkt të implementuar në bashkëpunim me bankat komerciale gjë që mundëson automatizimin e kryerjes së pagesave të rregullta nga ana e klientëve, në mënyrë më efikase.

Një element i rëndësishëm është edhe adaptimi i rregullave dhe standardeve ndërkombëtare për të përcjellur zhvillimet e reja në fushën e shërbimit të pagesave. Kjo mundësohet përmes harmonizimit të kornizës ligjore me direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian e cila është pjesë e vazhdueshme e angazhimeve të BQK-së.

Në funksion të avancimit të sistemit të pagesave, Banka Qendrore, në gusht të këtij viti, ka nxjerrë Rregulloren për Instrumentet e Pagesave Elektronike dhe ka amandamentuar Rregulloren për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave për të bërë harmonizimin e saj me rregulloren përkatëse të Bankës Qendrore të Evropës.

Vlerësoj se një rolë të rëndësishëm që mund të luaj Banka Qendrore dhe bankat komerciale është edhe promovimi i përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike përmes publikimeve dhe njoftimit të klientëve për mënyrën e përdorimit, por edhe informimit të tyre për përparësitë dhe sigurinë që ofrojnë bankat për kryerjen e këtyre shërbimeve.

Me anë të Rregullores së re për Instrumentet e Pagesave Elektronike janë adaptuar kërkesat për rritjen e transparencës ndaj klientëve, si dhe janë përcaktuar kushtet dhe obligimet e përdoruesve dhe të ofruesve të shërbimeve të pagesave elektronike. Kjo do të ndikoj në rritjen e transparencës dhe sigurisë për përdoruesit e instrumenteve të pagesave elektronike.

Në këtë drejtim është punuar edhe nga ana e bankave, ku pothuajse të gjitha prej tyre kanë avancuar shërbimet e tyre përmes ofrimit të mundësisë së kryerjes së pagesave 'online' dhe shërbimit përmes aplikacioneve telefonike, por edhe përmes krijimit të lokacioneve të njohura si "24/7" të cilat mundësojnë kryerjen e pagesave dhe deponimeve përmes ATM-ve përkatës përgjatë 24 orëve.

Përveç avancimit të mëtejshëm të infrastrukturës teknologjike, krijimit të hapësirës për shërbime të reja inovative dhe zhvillimit të mëtejshëm të infrastrukturës ligjore në harmoni me standardet ndërkombëtare dhe direktivat e BE-së, vlerësoj se një rolë të rëndësishëm që mund të luaj Banka Qendrore dhe bankat komerciale është edhe promovimi i përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike përmes publikimeve dhe njoftimit të klientëve për mënyrën e përdorimit, por edhe informimit të tyre për përparësitë dhe sigurinë që ofrojnë bankat për kryerjen e këtyre shërbimeve.

SHBK: A konsideroni se një avansim në qendrën e procesimit ndërbankar, respektivisht konsolidimit të bankomatëve dhe POS do të ndikonte pozitivisht në rritjen e transaksioneve elektronike dhe reduktimin e parasë së gatshme dhe a planifikohet që të ketë zhvillime në këtë drejtim?

Z.Mehmeti: Banka Qendrore ka kryer disa analiza që lidhen me këtë çështje, bazuar në të cilat vlerësohet se konsolidimi i një qendre vendore për procesim të pagesave përmes instrumenteve të pagesave elektronike (si kartela, e-banking, mobile banking, etj) e sidomos unifikimin e Pikave të Shitjes (terminaleve POS) dhe terminaleve ATM, do të ndikonte në rritjen e përdorimit të instrumenteve të pagesave, rrjedhimisht në reduktimin e përdorimit të parasë së gatshme. Lidhur me këtë çështje gjatë vitit 2016 është kryer edhe një studim i fizibilitetit për krijimin e një sistemi të mundshëm ndërbankar për transaksionet me POS dhe ATM, i mbështetur nga programi Qeveria-për-Qeverinë (Programi G2G) si partneritet nga USAID për zhvillimin e kapaciteteve lokale.



Nga analizat e kryera deri më tani, por edhe nga studimi në fjalë, ndërtimi i një qendre të tillë procesuese të transaksioneve ndërbankare me kartela kërkon një infrastrukturë dhe teknologji moderne, prandaj edhe ka një kosto relativisht të lartë.

Si rezultat i kësaj, Banka Qendrore është në proces të inicimit të një projekti me mbështetjen e Bankës Botërore për gjetjen e mënyrës më adekuate dhe më eficiente për nevojat e Kosovës për ndërtimin e një qendre të tillë për procesimin e pagesave dhe transfereve ndërbankare me kartela, në mënyrë që të unifikohet përdorimi i POS dhe ATM-ve për shfrytëzim përmes të gjitha kartelave të lëshuara nga bankat e ndryshme, e cila do të ndikonte në rritjen e efikasitetit dhe zvogëlimin e koston së këtyre transaksioneve. Kjo gjithashtu do të krijonte mundësinë e zgjerimit të rrjetit të terminaleve POS dhe ATM-ve, p.sh. përmes eliminimit të nevojës së përdorimit të shumë POS nga secila bankë në një lokacion, të cilat do të mund të shfrytëzoheshin për shpërndarje në ato lokacione ku mungojnë.

Njëkohësisht, në këtë relacion, Banka Qendrore ka punuar në vazhdimësi dhe është duke plotësuar dhe përshtatur infrastrukturën e nevojshme ligjore dhe rregullative që të krijojë hapësirën e duhur për licencimin dhe futjen në treg të institucioneve dhe operatorëve për shërbime të pagesave elektronike, siç janë p.sh., institucionet e parasë elektronike.

SHBK: Si e vlerësoni në përgjithësi gjendjen e sistemit bankar në Kosovë ?

Z.Mehemti: Objektivi primar i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës është ruajtja e stabilitetit financiar, objektiv të cilin po e realizojmë me shumë sukses. Sektori bankar i Kosovës, si komponenti kryesor i sistemit financiar, po dëshmohej të jetë një burim shumë i qëndrueshëm i financimit për ekonominë e vendit dhe po ashtu një burim shumë i rëndësishëm i stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik në sajë të shkallës së lartë të qëndrueshmërisë që ka.

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi me trend të rritjes edhe gjatë kësaj periudhe të vitit 2017, duke ruajtur tregues të mirë të likuiditetit, profitabilitetit dhe kapitalit. Vlera e gjithsej mjeteve të sektorit bankar, në muajin shtator 2017 arriti në 3.66 miliardë euro, duke shënuar

rritje vjetore krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar prej 9.3%. Struktura e mjeteve vazhdoi të financohet kryesisht nga depozitat dhe të jetë e përqendruar në aktivitetin e kredi-dhënies.

Gjithsej kreditë, në fund të muajit shtator 2017, janë në shumë prej 2.4 miliardë euro, të cilat shënuan rritje vjetore prej 10.3%. Përkundër rritjes së vazhdueshme të kreditimit, treguesi i kredive joperformuese ka shënuar rënie, ku në muajin shtator 2017 shënon normën prej 3.6% nga 5.1% sa ishte në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rezervat për humbjet nga kreditë vazhdojnë të mbulojnë kreditë joperformuese në nivel të kënaqshëm prej 140%. Gjithsej depozitat në shtator 2017 evidentojnë 3.07 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore me prej 8.6%.

Sektori bankar vazhdon të jetë mirë i kapitalizuar. Treguesi i kapitalit të bazuar në rrezik në muajin shtator 2017 regjistrohet 18.3%, i cili është lartë mbi kërkesat rregullatore të BQK-së prej 12.0%.

Sektori bankar i Kosovës, si komponenti kryesor i sistemit financiar, po dëshmohej të jetë një burim shumë i qëndrueshëm i financimit për ekonominë e vendit dhe po ashtu një burim shumë i rëndësishëm i stabilitetit të përgjithshëm makroekonomik në sajë të shkallës së lartë të qëndrueshmërisë që ka.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës do të vazhdojë t'i ofrojë sistemit financiar, e në veçanti atij bankar, të gjithë infrastrukturën e nevojshme financiare për zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe për rritjen e efikasitetit. Andaj, BQK-ja inkurajon sektorin bankar në Kosovë, që të angazhohet edhe më tepër në rritje të aktivitetit kredi-dhënës, me kushte edhe më të volitshme dhe me norma më të ulëta të interesit dhe tarifave për shërbime bankare.

PLATFORMAT DIGJITALE TË PAGESAVE DHE ZËVENDËSIMI I PARASË SË GATSHME.

Vitet e fundit, ndikimi i inovacioneve teknologjike në fushën e pagesave ka qenë transformues. Konsumatorët sot kanë qasje në një numër të madhe të alternativave për të kryer pagesa në formë elektronike. Njëkohësisht, konturet e tregut konkurrues për bankat komerciale në fushën e pagesave i kanë tejkaluar bankat si aktorë kryesorë, duke hapur tregun e pagesave edhe për kompani jo-financiare të orientuara nga FinTech, apo teknologji të reja financiare. **Por çfarë ofrojnë këto zhvillime të reja teknologjike, dhe pse efekti i tyre në ekonominë globale konsiderohet transformues?** Përgjigja është e thjeshtë. Sot klienti ka mundësi të pavarësoshet dhe të marrë në dorë kontrollin e marrëdhënies dhe të komunikimit të tij me bankat apo me kompani të tjera që mundësojnë blerje ose pagesa. Kjo sepse teknologjia sot mundëson pagesa elektronike që kryhen prej një numri të madh të pajisjeve elektronike të cilat përdoren gjerësisht në jetën e përditshme, si telefoni mobil, tableti, kompjuteri, kartela etj. Procesimi i këtyre pagesave po bëhet gjithnjë e më i shpejtë, i lehtë, më pak i kushtueshëm, kryhet në kohë reale 24/7, si dhe kryhet me një komoditet të lartë.

Konsumatorët në mbarë botën pritët të kryejnë rreth 726 miliard transaksione përmes platformave digjitale të pagesave deri në vitin 2020.

Si rezultat, gjatë dy-tre viteve të fundit, numri dhe volumi i pagesave elektronike në mbarë botën është rritur me ritme të shpejta. Në nivel global, transaksionet elektronike jo në para të gatshme gjatë viteve 2014 dhe 2015 janë rritur në normë 11.2%, rritje kjo nder më të lartat në dekadën e fundit. Sipas një studimi të Capgemini dhe BNP Paribas të publikuar në vitin 2017, konsumatorët në mbarë botën pritët të kryejnë rreth 726 miliard transaksione përmes platformave digjitale të pagesave deri në vitin 2020.

ZNJ. ERIOLA BIBOLLI

ZËVENDËS
DREJTORESHË
GJENERALE NË
BANKËN PROCREDIT



Cilat janë platformat e pagesave digjitale?

I. Kartelat e debitit apo kreditit, dhe kartelat pa kontakt për pagesa të shpejta. Sot, kartelat e debitit dhe të kreditit me përdorimin më të madh global janë kartelat e markave MasterCard dhe VISA. Fjala e fundit e teknologjisë në botën e kartelave janë kartelat pa kontakt për pagesa të shpejta të cilat së fundi kanë revolucionarizuar përdorimin e këtyre kartelave për pagesa elektronike. Në BE kartelat pa kontakt kanë një përdorim shumë të gjerë dhe sot kjo mënyrë pagese konsiderohet si shprehje normale dhe nuk përbën novacion. Gjatë vitit 2015, në Francë, kartelat pa kontakt të markës VISA janë dyfishuar në numër 40 milion, prej 20 milion kartelash aktive gjatë vitit 2014. Ndërkohë që tregu i Britanisë së Madhe përbën tregun më të madh të pagesave me kartela pa kontakt në Evropë, me një numër kartelash aktive prej 106.9 milion në vitin 2015.

Një shembull tjetër i suksesshëm i përdorimit të pagesave digjitale, dhe në veçanti i pagesave me kartela në Evropë është shteti i Danimarkës. Në bazë të publikimeve të Këshillit Evropian të Pagesave, 77% e danezeve të moshës 16-89 vjeç kanë blerë dhe paguar në formë elektronike gjatë vitit 2016. Në po të njëjtin vit, 81% e pagesave në ekonominë daneze bëhen me kartelë, dhe Danimarka është vendi i parë në BE për përqindjen e lartë të pagesave me kartela, kur mesatarja e shteteve të Bashkimit Evropian është 49%.

Çdo danez e përdor kartelën mesatarisht 330 herë në vit.

Çfarë ofron tregu bankar kosovar në këtë kontekst?

Në tregun bankar kosovar ka prani mjaft te kënaqshme të kartelave të debitit dhe të kreditit VISA dhe MasterCard të pranuar ndërkombëtarisht si pjesë e sistemeve globale të pagesave.

Në bazë të raporteve të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, ne shtator 2017 tregu kosovar ka pasur mbi 1 milion kartela debiti dhe krediti aktive, dhe numri i transaksioneve me kartela është në rritje të vazhdueshme.

Vlen të theksohet, që prej vitit 2016, Banka ProCredit ka qenë banka e parë që ka sjellë në tregun kosovar edhe kartelën e debit pa kontakt të markës MasterCard Debit, që mundëson pagesa të shpejta dhe të lehta, në harmoni të plotë me zhvillimet dhe trendet ndërkombëtare në botë në fushën e pagesave. Është inkurajues fakti që disa nga bankat e tjera komerciale në Kosovë e kanë ndjekur këtë ritëm të sjelljes së teknologjisë më të fundit të kartelave pa kontakt në vend, dhe sot konsumatori kosovar është në hap me kohën dhe i barabartë me konsumatorin evropian dhe global. Nëse do të pyesnim, pse konsumatori kosovar duhet të bëjë pagesa përmes kartelave pa kontakt, përgjigja edhe në këtë rast do të ishte e drejtpërdrejtë: është pagesë e shpejtë e lehtë e sigurt; është pagesë e integruar me sistemet globale ndërkombëtare të pagesave dhe ka pranueshmëri të lartë në mbarë botën, e jo vetëm në tregun e Kosovës.

II. Modernizimi dhe avancimi i platformave të bankimit elektronik apo e-banking

Bankimi elektronik është një mënyrë e bankimit përmes së cilës klienti kryen shërbime financiare si dhe pagesa elektronike prej llogarisë së tij bankare në një bankë komerciale përmes faqes së internetit të bankës.

Tregu bankar në Kosovë ka ecur me hapa të shpejtë dhe inkurajues në adaptimin dhe përdorimin e platformave të bankimit elektronik. Në shtator të vitit 2017 në treg raportohen rreth 320,314 llogari aktive të bankimit elektronik, ku shihet të ketë

një rritje mjaft të kënaqshme prej 41% krahasuar me vitin 2016, ku numri i këtyre llogarive ishte rreth 226,316.

Përparësia e klientit për të përdorur bankimin elektronik është qasja në llogari 24/7 dhe mundësia për të kryer transaksione dhe pagesa elektronike në çdo kohë, çdo ditë të javës.

III. Pagesat përmes telefonave mobile "smart phone", tabletave, dhe portofoleve digjitale

Përdorimi i telefonave mobile si mjet pagese për blerjen e produkteve dhe shërbimeve paraqet një tjetër ndryshim të modelit të sistemit të pagesave drejt pagesave digjitale. Ky ri-orientim nxitet kryesisht nga kërkesat dhe nevojat e konsumatorëve për të bërë pagesa përmes portofoleve elektronike të integruara në telefonat mobile të quajtura "portofole digjitale". Sipas studimit të VISA EUROPE mbi pagesat digjitale të publikuar në tetor të vitit 2016 numri i qytetarëve evropiane që përdorin telefonin mobil për të bërë pagesa është trefishuar gjatë vitit 2015 krahasuar me vitin 2014 (54% me 18%). Konsumatorët britanikë i kryesojnë këtë trendi duke qenë përdorues të pagesave përmes telefonit mobil në shkallën 74%.

Çfarë janë portofolet digjitale?

Portofolet digjitale janë versioni elektronik i portofoleve tradicionale që çdo individ mban me vete. Për konsumatorin, portofolet digjitale përmbajnë informacion dhe para në formë elektronike, të gatshme për të bërë pagesa. Për bizneset (apo merqantët), si pranues të këtyre pagesave, portofoli digjital paraqet një mënyrë tjetër alternative të pagesës. Është me rëndësi të theksohet që një portofol digjital është thjesht një ruajtje e koduar dhe e sigurt e informacionit/të dhënave në formë elektronike. Portofolet digjitale kanë përdorim të gjerë jo vetëm në fushën e pagesave, por edhe në fushën e ruajtjes së biletave elektronike, çelësave elektronike, kartelave të klientit të rregullt etj. Ndërkohë, një portofol në telefonin mobil është asgjë tjetër përveçse një version i portofolit digjital, përmes të cilit mund të kryhen disa lloje të pagesave elektronike.

Sot ekzistojnë disa lloje të pagesave elektronike përmes telefonit mobil, por dy ndër më të përdorurat janë:

- Pagesat përmes portofolit digjital të integruar në telefonin mobil. Këto pagesa janë forma alternative të pagesave të ngjashme me kartela të debitit apo kreditit, dhe përdorin teknologjinë pa kontakt të njohur si "tap and go". Portofole të tilla sot ofrohen përmes aplikacioneve të bankimit përmes telefonit mobil të zhvilluara prej bankave komerciale, apo përmes aplikacioneve të zhvilluara nga kompani jo financiare.
- Pagesat përmes platformave të ndryshme të mundësuar përmes telefonit mobil. Shembull i këtij lloji të pagesës është platforma e krijuar nga kompania PayPal e themeluar në vitin 1998, e cila mundëson pagesa të drejtpërdrejta klient - klient, ose pagesa online tek tregtar të ndryshëm. Përdorimi i këtyre pagesave mori hov të veçantë pas vitit 2010, si rezultat i rritjes drastike të përdorimit të telefonave mobile, gjë që solli krijimin e platformave të pagesave elektronike si: "Portofoli Google" në vitin 2011, "Apple Pay" në vitin 2014, etj.

Megjithatë, sfidat për këtë instrument të pagesave digjitale janë evidente. Së pari adresimi në kohë i çështjeve të sigurisë së pagesave digjitale përmes telefonave mobile, veçanërisht i pagesave digjitale të kryera prej aplikacioneve të zhvilluara nga kompani jo financiare të cilat nuk janë subjekt i mbikëqyrjes dhe rregullativës bankare.

Çfarë ofron tregu Kosovar?

Përdorimi i pagesave përmes telefonave mobile është në fazë fillestare në tregun e Kosovës. Aktualisht është një numër i vogël i bankave komerciale që ofrojnë pagesa përmes portofoleve digjitale të integruara në telefona mobile, dhe njëkohësisht ka mungesë të infrastrukturës së terminaleve të shitjes tek merqantët për të pranuar pagesa të tilla përmes telefonit.

Megjithatë, duke ndjekur trendet e rritjes së shpejte të këtyre pagesave në tregjet globale dhe duke pasur parasysh inovacionin teknologjik të pandalshëm, konfigurimi i kësaj infrastrukture në tregun e Kosovës pritet të

ndryshojë shumë shpejt. Këto pagesa pritet të depërtojnë me ritme të shpejta edhe në tregun e Kosovës, dhe pritet të jenë pagesat digjitale të së ardhmes.

IV. Blerjet online përmes platformës së tregtisë elektronike (e-commerce)

Termi tregti elektronike apo e-commerce i referohet blerjes dhe shitjes së mallrave dhe shërbimeve online përmes kanaleve elektronike, si interneti. E-commerce si model biznesi dhe si mënyrë inovative e pagesave elektronike i ka fillimet e veta prej vitit 1960, por ka marrë hov të jashtëzakonshëm me rritjen drastike të qasjes në internet të një pjese të popullsisë globale, dhe njëkohësisht me zhvillimin e suksesshëm të modeleve të reja të biznesit, si Amazona në vitin 1995 dhe Ebay në vitin 1997.

Nëse do të pyesnim, pse konsumatori kosovar duhet të bëjë pagesa përmes kartelave pa kontakt, përgjigjja edhe në këtë rast do të ishte e drejtpërdrejtë: është pagesë e shpejtë e lehtë e sigurt; është pagesë e integruar me sistemet globale ndërkombëtare të pagesave dhe ka pranueshmëri të lartë në mbarë botën, e jo vetëm në tregun e Kosovës.

Çfarë ofron tregu Kosovar në fushën e e-commerce?

Ky shërbim ekziston aktualisht edhe në tregun Kosovar, ku sipërmarrës dhe biznese të ndryshme kanë mundësuar shitjen online të produkteve dhe shërbimeve, përmes platformave të pagesave "gateway" të ofruara nga bankat komerciale në Kosovë. Platforma e pare "gateway" për blerje online përmes internetit në Kosovë është ofruar nga Banka ProCredit në vitin 2013. Ritmet e pagesave në këtë platformë janë mesatare, por ngjashëm me zhvillimet në mbarë botën, edhe ky model biznesi dhe kjo formë e tregtisë dhe pagesave elektronike përbën potencial të pashfrytëzuar në Kosovë që pritet të lulëzojë dhe të arrijë momentum në një të ardhme të afërt.

V. Digjitalizimi i sektorit bankar në Kosovë dhe përvoja e deritanishme e Bankës ProCredit

Në harmoni me digjitalizimin e ekonomisë globale dhe të asaj Kosovare, si rrjedhojë e zhvillimeve të vrullshme teknologjike dhe inovacionit, Banka ProCredit është banka e parë në tregun kosovar që ka ofruar një koncept të integruar të bankimit digjital, ku përbërës thelbësor i tij ka qenë modernizimi i platformave të pagesave elektronike. Funksionalizimi i Zonave 24/7 gjatë vitit 2014 dhe 2015, si dhe integrimi i këtij koncepti me modernizimin e platformës së bankimit elektronik, të bankimit përmes telefonit mobil, ri-modelimin e komunikimit me klientë përmes faqes së internetit dhe qendrës së kontaktit, etj., kanë ofruar në tregun kosovar një koncept unik të bankimit modern në hap me kohën. Ky koncept i bankimit është kthyer në një prej objektivave strategjike të bankës ProCredit si dhe të shumë bankave komerciale në mbarë botën. Është kënaqësi të theksohet që klientët kosovarë e kanë mirëpritur këtë koncept të ri të bankimit me rritme shumë të shpejta dhe kanë adaptuar shprehinë e tyre të bankimit duke përqafuar të gjitha kanalet elektronike të pagesave dhe të menaxhimit të parave të gatshme. Sot 100% e të gjitha transaksioneve në nivel të bankës ProCredit klientët i kryejnë përmes platformës elektronike dhe Zona 24/7.

Çfarë do të sjellë e ardhmja? Rritja e pashmangshme e pagesave digjitale dhe ekonomia me më pak para të gatshme

Ndërkohë që ne diskutojmë dhe flasim për pagesa digjitale dhe trendet botërore, bota rreth nesh vazhdon të adoptojë me ritme të shpejta dhe të pandalshme teknologjinë digjitale, e cila po vazhdon të ndikojë në mënyrë rrënjësore platformat dhe sistemet aktuale të pagesave. Sipas revistës *Business Insider*, shtete si Suedia, Singapori, Holanda, Franca, Kanadaja, Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar po transformohen në ekonomi pa para të gatshme. Në Suedi, gjatë vitit 2016, vetëm 1% e transaksioneve janë kryer në para të gatshme, ndërsa pjesa tjetër në forma digjitale. Ndërkohë Kryeministri i Indisë në nëntor 2016 njoftoi për vendimin e qeverisë së tij për të de-monetizuar shtetin e tij, duke larguar nga qarkullimi bankënotat me vlerë të

madhe në qarkullim, që përbejnë rreth 86% të qarkullimit në para të gatshme në këtë vend, kur pagesat në para të gatshme përbëjnë rreth 98% të transaksioneve. Në këtë mënyrë, India ka përqafuar mundësitë që ofron bankimi digjital dhe teknologjia, dhe po rrit ndjeshëm përdorimin e pagesave elektronike përmes kartelave, dhe portofoleve digjitale.

Megjithatë, pavarësisht që pagesat digjitale janë në rritje, paraja e gatshme vazhdon të mbetet mënyrë pagese, e pranishme në ekonominë globale, por me prezencë dukshëm më të reduktuar.

Ekonomia e Kosovës me më pak para të gatshme, ëndërr apo realitet?

Nëse i kthehemi tregut bankar të Kosovës, pavarësisht historisë së shkurtër të këtij sektori, mund të konstatohet se në mënyrë të vazhdueshme vërehet përmirësim i infrastrukturës së pagesave elektronike në vend, rritje e vazhdueshme e platformave të pagesave, avancim i kësaj infrastrukture dhe adaptim i formave të avancuara dhe moderne të teknologjisë. Njëkohësisht, instrumentet e pagesave elektronike në Kosovë ofrojnë elementet e nevojshëm të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë të një sistemi pagesash, dhe adaptimi i teknologjive të avancuara të sigurisë kibernetike mbetet prioritet i sistemit bankar. Megjithatë, pjesëmarrja e blerjeve dhe pagesave me para të gatshme në ekonomi vazhdon të mbetet ende e lartë, krahasuar me trendet globale të përmendura me lart. Ndaj ka hapësirë për të rritur ndjeshëm përdorimin e instrumenteve aktuale të pagesave elektronike. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet ofrimit të formave të reja të pagesave elektronike, dhe inkurajimit të klientëve për të përfutur nga mundësitë e pakufishme që ofrojnë avancimet teknologjike sot. Një zhvillim i tillë do të zvogëlonte dukshëm nivelin e parasë së gatshme në qarkullim; do të kontribuonte ndjeshëm në reduktimin e ekonomisë jo-formale dhe në luftën kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Në fund, bankimi digjital, si një model i ri biznesi, i ofruar përmes instrumenteve të shumëfishta të pagesave elektronike, i reflektuar në reduktim të parasë së gatshme në qarkullim është e ardhmja e modelit të pagesave në një shekull ku inovacioni teknologjik është transformues dhe i pandalshëm.

E-DREJTA PER PAGESA ELEKTRONIKE DHE REDUKTIMI I PARASË SË GATSHME SI INSTRUMENT PAGESE

Më shumë se 20% të qytetarëve të Evropës shumë rrallë përdorin para të gatshme, ndërsa çdo i treti deklaron se do të kishte lënë paratë e gatshme si instrument pagese për të përdorur format elektronike të pagesës, nëse do të kishte këtë mundësi.

Kosova dhe preferencat e konsumatorëve të Kosovës me hapa të shpejta i përcjellin trendet globale dhe klienti kosovar është i vetëdijshëm për disavantazhet e përdorimit të parave të gatshme që lidhen me kosto më të lartë, pasiguri, parehati dhe rrezik nga humbja apo vjedhja.

Reduktimi i përdorimit të parave të gatshme në Kosovë ka qenë qëllim i tërë sektorit financiar në dekadën e fundit. Në bazë të bashkëpunimit mes sektorit bankar dhe Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) që në vitin 2011 janë bërë hapat e parë për reduktimin e përdorimit të parave të gatshme dhe për inkurajimin e përdorimit të formave elektronike të pagesave.

Zhvillimi i teknologjisë digjitale, përmirësimi i penetrimit me internet dhe me pajisje smart në tregun e Kosovës ju ka mundësuar bankave që të zhvillojnë dhe lansojnë instrumente të reja të pagesave elektronike.

Bankat tanimë ofrojnë alternativa të shumta të parave të gatshme, duke iu mundësuar klientëve një gamë të gjerë të instrumenteve të pagesave jo-kesh:

Kartelat debitore dhe kreditore, Transferet e kreditit dhe Kos Giro përmes e-banking apo Mobile banking, si dhe Debitimi Direkt, të gjitha këto instrumente të pagesave jo-kesh me të cilat përdoruesit e këtyre shërbimeve transferojnë fonde mes llogarive në banka apo institucione të tjera financiare. Po ashtu, infrastruktura bankare e shërbimeve të pagesave në Kosovë karakterizohet me një zhvillim të qëndrueshëm, i prirë me rritje dhe zgjerim si në aplikim të teknologjive inovative ashtu edhe në përdorim të instrumenteve elektronike.

ZNJ. BORYANA IVANOVA MUSTAFA

DREJTORE E DIVIZIONIT
TË PAGESAVE DHE
THESARIT NLB BANK



Vetëm para 5 viteve 25% të konsumatorëve të Kosovës deklarorin se me pagesë jo-kesh e humbin kontrollin e plotë mbi financat personale, ankoheshin për mungesën e POS terminaleve aty ku bëjnë blerjet, për preferencën e shitësit të paguhen me cash, për çmimet më të larta nëse pagesa bëhet me kartela, për probleme me POS terminalin ose për vonesa në procesim të pagesave.

Ndërsa në shtatë vitet e fundit vërehet një tendencë e rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike të pagesave.

Në vitin 2017 mbi 70% të pagesave që kalojnë përmes sektorit bankar kryhen përmes kanaleve elektronike. Pagesat që kryhen në sportelet e bankës dhe jo përmes kanaleve elektronike kryesisht janë : Xhiropagesat ndaj Doganës, ndaj kompanive të Sigurimeve, ndaj operatorit të tretë në Kosovë. Nga totali i llogarive, në fund të vitit 2016, rreth 231 mijë llogari kanë qasje "online" nga interneti për të kryer urdhërpagesa, për të kontrolluar gjendjen e llogarisë apo për të aplikuar për shërbime të ndryshme bankare, duke shënuar një rritje prej 23.3% në krahasim me vitin 2015 dhe duke u pesëfishuar në krahasim me vitin 2009 (41 mijë përdorues të shërbimit e-banking). Zgjerimi i rrjetit të bankomateve (ATM) ka shënuar rritje me 54% në shtatë vitet e fundit, ndërsa mbi 5000 POS Terminale shtesë janë funksionalizuar në këtë periudhë duke rritur numrin e POS Terminaleve me 102%.

Rritja në %

Kosova	Viti 2009	Viti 2016	2016 vs 2009
Banorë	2.10	1.77	
Sipërfaqja (km ²)	10,887	10,887	
Densiteti (për km ²)	193	163	

ATM	339	522	54%
për 1 milion banorë	161	295	
për 100 km ²	3	5	


POS	5,251	10,589	102%
për 1 milion banorë	2,500	5,982	

Kredit Kartelat	31,508	156,437	396%
për 1 milion banorë	15,004	88,382	

Debit Kartelat	507,399	856,718	69%
për 1 milion banorë	241,619	484,021	

E-Banking	40,924	230,905	464%
------------------	---------------	----------------	-------------

Përdorimi i Instrumenteve të Pagesave elektronike 2009 vs. 2016





Transformimi i kërkesave të shoqërisë evropiane dhe shoqërisë së Kosovës i kanë shtyer bankat që të jenë në hap me avancimet teknologjike duke iu ofruar klientëve mundësi për kryerjen e transaksioneve në mënyrë efikase dhe të sigurt në çdo kohë dhe nga çdo vend, duke kursyer kohën e tyre.

Prandaj rritja e numrit të instrumenteve elektronike nuk është qëllimi i vetëm i bankave, por rritje e mundësisë për plotësimin e nevojave të vazhdueshme të konsumatorëve të Kosovës, duke ju ofruar shërbime sa më të përshtatshme dhe të shpejta që do të jenë në dispozicion 24/7/365.

Sfidat

Përderisa në bankat e Kosovës pjesa më e madhe e pagesave tanimë kryhen në mënyrë elektronike, kjo tendencë nuk vlen për shumë kompani publike, institucione qeveritare dhe biznese që janë ende në transformim e sipër.

Një pjesë e madhe e Institucioneve, duke përfshirë disa industri siç janë ato të telekomunikacionit dhe të energjisë, nuk arrijnë të përcjellin trendet dhe zhvillimet

e shpejta në modernizimin e sistemit të pagesave dhe nuk ndërmarrin hapa real për përmirësimin e sistemit të tyre, për zhvillimin e mundësive të komunikimit nëpërmjet webserviseve.

Zhvillimi i teknologjisë digjitale, përmirësimi i penetrimit me internet dhe me pajisje smart në tregun e Kosovës ju ka mundësuar bankave që të zhvillojnë dhe lansojnë instrumente të reja të pagesave elektronike.

Shlyerja e urdhërpagesave të klientëve brenda Kosovës kryhet përmes sistemit të avancuar të kliringut ndërbankar ATS (Sistemi i transferit automatik) të BQK-së, të implementuar në vitin 2016, që mundëson procesimin e pagesave në vlera të vogla në 3 sesione brenda orarit të punës së sistemit (ACH) dhe pagesave me vlera të mëdha dhe prioritare në kohë reale që shlyhen brenda 5 minutave (RTGS). Ndërsa në vitin 2017 ka hyrë në fuqi edhe Rregullorja për instrumentet e pagesave elektronike.

Krahas masave për përmirësimin e lartëpërmendur të zhvillimeve të infrastrukturës dhe bazës ligjore, në bazë të bashkëpunimit mes Bankës Qendrore, sektorit bankar dhe Ministrisë së Financave vite më parë është bërë edhe standardizimi i faturave me kod referent unik me qëllim të unifikimit dhe të standardizimit të procesimit të pagesave qeveritare (pagesat masive), si dhe për lehtësimin e azhurnimit dhe barazimit të të dhënave të pagesave të pranuar.

Shumica e pagesave në vlera të vogla në favor të institucioneve të ndryshme qeveritare, jo-qeveritare apo private kryhen nga klientët e bankave nëpërmjet kanaleve elektronike, por shlyerja e mjeteve dhe barazimi i kreditimit final të përfituesit ndodh një ditë më vonë. Prandaj ka raste kur klientët urdhëruar janë të detyruar që pagesën e kryer përmes e-banking ta shtypin në formë letre, ta dërgojnë në bankë për vendosjen e vulës origjinale dhe më pas të dorëzojnë kopjen fizike si dëshmi në institucionin përfitues.

Në këtë mënyrë dërgimi i kopjes fizike e bën të pakuptimtë e-procesimin dhe e cungon ciklin komplet të automatizimit të procesimit të pagesave.

Sa i përket përfituesve të skemave pensionale, pas ndalesës më shumë se 10 vjeçare nga institucionet përkatëse shtetërore për pajisjen me kartela debitore dhe pas negociatave të gjata dhe insistimit të sektorit bankar, pjesa më e madhe e tyre tashmë është pajisur me kartela debitore.

Përfituesit e skemave të Asistencës sociale dhe kategorive tjera pranojnë mjetet përmes llogarive bankare, por ende në formë keshi, pa pasur mundësi ligjore që të pajisen me kartela debitore duke i përjashtuar në këtë mënyrë komplet nga ofrimi i shërbimeve financiare. Pagesat në kesh rezultojnë në pasoja të pakthyeshme sociale dhe financiare – humbje kohe, pritje në rradhë të gjata në bankë apo institucione tjera, ofrimin e solucioneve afatshkurtra, klientët vihen në rrezik - nga vjedhja dhe me ndjenjë të thellë për pasiguri.

Roli i Autoriteteve Shtetërore

Kostoja financiare dhe sociale e qarkullimit të parave të gatshme për një shteti sillet rreth 0.5% deri në 1.5% të BPV-së. Përdorimi i parave të gatshme rrit shpenzimet për distribujmë të keshit, rrit humbjen e kohës për pritje në rradhë, nxit ekonominë informale, lehtëson zhvillimin e korrupsionit, mashtrimeve, terrorizmit dhe evazionit fiskal.

Për të nxitur rritjen ekonomike, për të ulur kostot dhe për të ndihmuar në grumbullimin e tatimeve dhe të hyrave qeveritare, Autoritetet shtetërore duhet t'i kushtojnë rëndësi të veçantë reduktimit të parasë së gatshme, krijimit të kushteve për funksionimin e instrumenteve elektronike të pagesave, funksionalizimin e E- Qeverisë, modernizimin dhe digjitalizimin e ciklit komplet të pagesave dhe të disbursimeve.

Kostoja financiare dhe sociale e qarkullimit të parave të gatshme për një shteti sillet rreth 0.5% deri në 1.5% të BPV-së.

Me qëllim të nxitjes së mëtejshme të transparencës dhe progresit social të shoqërisë, nevojitet të gjejnë mënyra dekurajuese më të përshtatshme financiare dhe sociale për të zvogëluar qarkullimin e parasë së gatshme, për të favorizuar pagesat elektronike dhe për t'ju mundësuar qytetarëve përdorimin e e-formave digjitale të komunikimit dhe të pagesës.

Ndërsa E-drejta për të përdorur dhe adoptuar të gjitha alternativat e ofruara duhet t'i lihet konsumatorit dhe avancimit teknologjik.

Burime:

Statistikat e BQK-së

ING International Survey Mobile Banking 2017 – Cashless Society

SHBK anketa

DIGJITIZIMI - PËRGATITJA PËR TË ARDHMEN

Në kushtet e konkurrencës së ashpër dhe zhvillimit relativisht të ngadaltë ekonomik, subjektet ekonomike në industrinë financiare janë nën një presion serioz të digjitalizimit - një proces revolucionar në botën e sotme që nënkupton një transformim të plotë të modeleve të tyre të biznesit dhe përshtatjen e strategjive për t'iu përgjigjur realitetit të ri dhe të kontribuojnë në zhvillimin e tyre: uljen e kostove dhe nevojave të investimeve në digjitalizimin e proceseve të biznesit.

Pjesa më e madhe e menaxherëve në shërbimet financiare mendojnë se strategjitë e tyre duhet të digjitalizohen në drejtim të strategjive të adaptueshme lehtë, të diferencuara, dhe marrëdhëniet të ndryshuara të konsumatorëve, ndërkohë që teknologjitë e reja të shpejta (inteligjencës artificiale, të mësuarit e makinave me të dhëna masive) do të kontribuojnë në përvoja krejtësisht të reja.

Këto dhe rezultate të ngjashme janë të dukshme në një raport të publikuar së fundmi nga revista Forbes e titulluar "Digjitalizimi

ZNJ. KATERINA BOSHEVSKA

MSC - DREJTOR
MENAXHUES I EOS
MATRIX NË MAQEDONI,
KOSOVË, DHE MAL TË ZI



i shërbimeve financiare - Zotërimi Digjital Dallon Liderët nga të Ngathtët". I përgatitur nën kujdesin e Njohësit, raporti shqyrton transformimin e vazhdueshëm të subjekteve ekonomike në sektorin financiar përmes procesit të digjitalizimit.

Drejtuesit e shërbimeve financiare që morën pjesë në sondazhin perceptojnë një korrelacion direkt midis digjitalizimit dhe rritjes së ardhshme të kompanisë - ata besojnë se 25% e rritjes së tyre në të ardhmen do të jetë e nxitur nga vendime të bazuara në strategjitë

Kohëve të fundit në rajon, kompanitë FINTECH janë duke u konsideruar si udhëheqëse në digjitalizim në industrinë financiare. Karakteristikat themelore për këto kompani relativisht të reja dhe me rritje të shpejtë janë shkathtësia, digjitalizimi, dhe inovacioni.

Këto karakteristika janë vetëm një segment i kodit EOS.

EOS ndryshe nga kompanitë FINTECH kombinon këto karakteristika, në veçanti inovacionin dhe fleksibilitetin me përvojë dhe përgjegjësinë lidhur me EOS, bazuar në traditën e gjatë të kompanisë dhe praninë në treg për dekada të tëra. Gjithmonë në ballë kur është fjala për zbatimin e teknologjive të reja në operacionet tona ditore sepse ne duam të mbesim në mesin e ofruesve më efikas të shërbimeve për menaxhimin e të arkëtueshmeve dhe gjithmonë të ofrojmë produkte tërheqëse për klientët tonë.

Aktualisht, dy projekte të rëndësishme janë duke u zhvilluar në nivelin tonë të Grupit në këtë kontekst.

E para ka të bëjë me shfrytëzimin e avantazheve të digjitalizimit në drejtim të pozicionimit të EOS si një lider teknologjik në fushën e menaxhimit të të arkëtueshmeve.

E dyta ka të bëjë me pozicionimin e duhur të EOS në kontekstin e ndryshimeve që digjitalizimi do të sjellë në sjelljet e kompanisë, vlerat, dhe marrëveshjet e brendshme.

Këto dy projekte hapin rrugën për EOS në të ardhmen.

digjitale. Dështimi për të ndjekur digjitalizimin mund të jetë shkatërrimtar për kompanitë. Gati 71% e të anketuarve konsiderojnë se ata që nuk përdorin teknologjitë moderne për të transformuar strategjitë e tyre janë në rrezik të rritur të çrregullimit të proceseve të tyre të biznesit apo edhe margjinalizimit të tregut. Megjithatë, vetëm një në gjashtë pjesëmarrës në studim e përshkruan veten si lider në përdorimin e teknologjisë në kuptim të ofrimit të shërbimeve dhe diferencimit të përvojave të konsumatorëve.

Sondazhi zbulon faktorët kufizues për të investuar në digjitalizim: 43% e të anketuarve preferojnë të jenë pasues të shpejtë kundrejt të qenit levizësit e parë në procesin e digjitalizimit për shkak të kostove të larta të kryesimit të procesit, mungesës së stafit të talentuar dhe profesional, si dhe paaftësisë për të ndarë zhvillimin e buxhetit në të gjithë ndërmarrjen. Në çdo rast, 60% e të anketuarve besojnë se programet e mëdha të të dhënave do të japin rezultate rreth një viti pas aplikimit të tyre, 55% konsiderojnë të njëjtën gjë në lidhje me aplikacionet mobile, dhe 54% për aplikacione të avancuara mobile. Këto periudha të shpejta fitimi të lidhura me kthimin e investimeve në digjitalizim janë më shumë se një mesazh i qartë se teknologjia do të sigurojë zhvillim të vazhdueshëm dhe të shpejtë dhe të sjellë avantazh konkurrues dhe për këto arsye do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme se kush do të zbatojë strategjitë e digjitalizimit dhe të aplikojë teknologjitë moderne digjitale së pari.

Një tjetër pamje e digjitalizimit është paraqitur në studimin e Ernst & Young dhe Universitetin e St. Gallen nga Zvicra, i cili për herë të parë tregon shkallën në të cilën besimi i klientëve në ofruesit e shërbimeve financiare, vuan në kushte kur kontakti personal me klientin neglizhohet si pasojë e inovacioneve teknologjike. Studimi është i pari i këtij lloji që shqyrton sjelljen e klientit në aspektin se si ata ndërtojnë besimin me botën digjitale. Studimi jep rekomandime se si besimi dhe marrëdhënia me klientin mund të vazhdojë të mbahet dhe ruhet në botën digjitale. Ka shumë mënyra për të ruajtur besimin, duke digjitalizuar shërbimet dhe duke komunikuar me klientët përmes kanaleve digjitale.

Studimi rekomandon që subjektet ekonomike të kombinojnë informacionin që hasin nëpër portalet e tyre për çdo klient individual dhe

pastaj ti përdorin për ofertat e tyre apo në komunikim personal me klientin, duke çuar kështu në një vlerë vërtetë të shtuar për klientin. Gjithashtu, nga ky studim mbetet e paqartë se deri në çfarë mase mund të ndryshojë sjellja e klientit si pasojë e zhvillimeve të ardhshme teknologjike. Megjithatë, kjo është shumë e rëndësishme për përcaktimin e strategjive të ardhshme të ofruesve të shërbimeve financiare, në veçanti në përgjigjen e pyetjes nëse brezat e ardhshëm do të vazhdojnë ta çmojnë shumë kontaktin personal, ose ajo mund të zëvendësohet plotësisht nga ndërveprimi digjital.

Në një kohë kur e gjithë industria financiare vazhdon të vuajë pasojat e besimit të humbur si pasojë e krizës së fundit financiare, dhe në të njëjtën kohë duke u shtypur nga nevoja për reagim të shpejtë në procesin e digjitalizimit, ofruesit e shërbimeve financiare sfidohen për t'iu përgjigjur revolucionit digjital në njërën anë dhe për të forcuar rregullat e sigurisë së të dhënave dhe përputhshmërisë së plotë me standardet ndërkombëtare në anën tjetër.

Proceset e shpejta dhe efikase, niveli i lartë i transparencës, dhe siguria e certifikuar dhe e konfirmuar e të dhënave për klientët tanë janë kritere shumë të rëndësishme për EOS, kompani e cila gjithmonë mund t'iu dëshmojë dhe konfirmojë këtë klientëve tanë.

Sistemet e cilësisë të përkthyer në ISO 20000 dhe ISO 27001, standarde me të cilat kompania EOS Matrix është certifikuar, dhe sidomos niveli i lartë i përkushtimit të kompanisë për zbatimin e tyre, siguron besimin në mesin e klientëve tanë.

Digjitalizimi gradualisht po shndërrohet në jetën tonë të përditshme. Digjitalizimi po ndodh tani. Ndikimi i tij është shumëdimensional dhe i vazhdueshëm. Kompanitë në industrinë financiare duhet të veprojnë shpejt për të krijuar një strategji digjitale përmes së cilës ata do të ri-përcaktojnë mënyrën se si ata kryejnë biznesin e tyre. Inovacioni digjital dhe strategjitë janë çelësi për të bërë një ndryshim në aspektin e konkurrencës dhe përmirësimit e operacioneve të biznesit.

TRENDET, NDRYSHIMET DHE RITJJA E PAGESAVE PËRMES PLATFORMAVE DIGJITALE

Operimi me para të gatshme, sot mund të konsiderohet njëra nga veprimet më të kushtueshme, shumë të mundimshme, thënë thjeshtë jo lehtë e menagjueshme. Ky fakt vlen jo vetëm për bankat, por gjithashtu bizneset e vogla dhe të mëdha. Dhe që është shumë e rëndësishme, vështirësitë e operimit me para të gatshme janë duke u paraqitur dhe vërejtur edhe nga vete klientët edhe në Kosovë, edhe ata të cilët më herët donin të kishin paranë e gatshme në duart e veta.

Në ditët e sotme, paratë e gatshme në shumë raste nuk mundësojnë të bësh një pagesë, të marrësh një shërbim, apo edhe të japish shërbim tek klientët. Kjo për arsyen e zhvillimit dhe evoluimit të tregut, por dhe metodave dhe kanaleve elektronike të të bërit biznes.

Zhvillimi i hovshëm teknologjik, në veçanti i teknologjisë informative i ndërlidhur dhe i përshtatur mirë me sistemet bankare dhe sistemet e pagesave në përgjithësi, është duke ofruar mundësi të shumta për të plotësuar nevojat e klientëve për të gjitha nivelet e pagesave.

Ky trend i zhvillimit është mjaft i dukshëm madje dhe imponues edhe tek ne, është momenti kur nevojat dhe kërkesat e vetë klientëve janë duke u bashkë-dyzuar me nevojat për ndryshimet edhe në sistemin bankar në Kosovë.

Është një trend i mirë i bankave në Kosovë për të shtyrë dhe zhvilluar më tutje platformat digjitale të pagesave, dhe largimi sa më shumë që është e mundshme nga metodat manuale të operimit me para të gatshme. Madje disa nga bankat kanë bërë hapa shumë të rëndësishëm dhe vendimtar në këtë drejtim. Vlen të përmendet ProCredit Bank e cila ka aplikuar një metodë dhe strategji shumë konkrete për reduktimin e operimit me para të gatshme, duke reduktuar pothuajse operimin me para të gatshme në pikat shërbyese dhe duke e

Z. AFRIM GËRGURI

SPECIALIST I LARTË
PËR OPERACIONE ME
KARTELA



orientuar të njëjtën në kanale elektronike, në mënyrë që përmes pikave shërbyese klientët të vazhdojnë të informohen për produkte dhe shërbime bankare më komplekse, të marrin informacionin dhe këshillimin e nevojshëm për shërbimet bankare.

Vështirësitë e operimit me para të gatshme janë duke u paraqitur dhe vërejtur edhe nga vete klientët edhe në Kosovë, edhe ata të cilët më herët donin të kishin paranë e gatshme në duart e veta.

Strategji të tilla natyrisht janë përcjellë me investime shumë të larta në teknologji, kjo për të ofruar kanale tjera të shërbimit, të përshtatshme dhe më të lira për vetë klientët.

Në sistemin bankar në Kosovë, kohëve të fundit është duke u vërejt një trend i lartë i investimeve në zhvillimin e platformave digjitale. Pothuajse të gjitha bankat në mënyrë vetanake janë duke zhvilluar platformat e tyre, në mënyrë që klientëve të vetë të u mundësohen metoda sa më të përshtatshme për kryejnë e shërbimeve, gjegjësisht transaksioneve.

Një ndër platformat me te njohura deri më tash në Kosovë është platforma digjitale/elektronike e quajtur e-Banking (Elektronik banking).

Zakonisht kjo platformë ju ofrohet klientëve në versionin e 'web' apo edhe si aplikacion mobil që mund të shfrytëzohet përmes pajisjeve mobile, ku ndër më të preferuarat nga klientët janë telefonat e mençur.

Përmes këtyre platformave deri më tash shërbimet që u ofrohen klientëve kanë qenë të kufizuara në: transferta kombëtar dhe ndërkombëtar, pagesa për institucione të ndryshme, etj.

Zhvillimet e fundit kanë filluar plotësimin e kësaj platforme elektronike me elemente tjera për pagesa të ndryshme periodike, menaxhimin dhe integrimin e pajisjeve tjera për pagese(kartela), etj.

Një ndër platformat me te njohura deri më tash në Kosovë është platforma digjitale/elektronike e quajtur e-Banking (Elektronik banking).

Integrimi i kartelave në e-Banking dhe shfrytëzimi i tyre për pagesa direkt është një hap me shumë për të u ofruar me versionet e ashtuquajtura 'digital wallet' të cilat ofrohen nga kompanitë e fuqishme të teknologjisë por tash edhe të pagesave si Apple Pay, Samsung Pay, MC Wallet, etj.

Kjo është e ndërlidhur ngushtë me pajisjet mobile (telefonat e mençur) e njohur si platformë e pagesave përmes pajisjeve mobile (mobile payment), dhe bazuar në trendin aktual në botë pritet të mbajë vendin kryesor të pagesave në platformën digjitale.

Natyrisht që shfrytëzimi i kësaj platforme kërkon përkrahje nga aspekti teknologjik harduerik dhe ai softuerik.

Ajo çka duhet të përvetësohet nga pjesëmarrësit në ekosistemin e menaxhimit të transaksioneve në përgjithësi, është roli i telefonave të mençur dhe impakti që kanë në mënyrën e bankimit të të ardhmes. Ky objekt personal i cili dita ditës po ia zëvendëson klientit nevojën për të përdorur pajisje të tjera bankare siç janë kartelat, tokeni i sigurisë etj.

Për pagesat fizike tek pikat e shitjes(POS) janë të njohura metodat standarde të pagesave me kontakt, por përveç janë mjaft të njohura edhe ato pa kontakt:

Contactless – pagesë pa kontakt përmes kartelës, apo 'stikereve' të vendosur në telefon, ose, apo pajisje tjetër të preferuar nga klienti.

Këtë teknologji përmes kartelave me 'contactless interface' kanë filluar të ofrojnë për klientët shumica e bankave në Kosovë. Gjithashtu është bërë një investim i dukshëm edhe në pajisjet të cilat pranojnë këtë teknologji dhe kartela me këto funksione(POS terminale). Sipas disa statistikave të fundit, numri i terminaleve të cilat pranojnë pagesat pa kontakt(Contactless) në Kosovë ka kaluar numrin 1000.

Teknologjia e NFC ('Near Field Communication'), teknologji e cila shfrytëzohen funksionin pajisjes mobile për të kryer pagesa.

Janë gjithashtu mjaft interesante metoda tjera të pagesave të kombinuara me ato më lartë të përmendura, të cilat kanë filluar të aplikohen në vendet tjera, por që për një të ardhme të afërt mund të ofrohen edhe në Kosovë.

Për shembull shfrytëzimi dhe leximi i QR Code për të bërë pagesa, digjitale është duke u aplikuar në shumë vende të botës.

Një metodë tjetër e pagesave digjitale, në distancë e njohur si 'E-Commerce' është duke u përkrahur që disa vite edhe në Kosovë. Përmes kësaj metode, klientëve ju mundësohet që në distancë të paguajnë përmes internetit për produktet që ata kanë përzgjedh nga shtëpia ose pse jo edhe telefoni mobil.

Me këtë klientëve ju mundësohet që të bëjnë pagesa për produkte apo shërbime në çfarëdo kohe dhe prej çdo vendi, mjafton të ketë internet.

Gjithashtu bizneseve u ofrohen mundësi shumë më të lehta dhe të lira të menaxhimit të mallrave dhe hapësirave të nevojshme. Është e vlefshme të ceket se përveç rritjes së numrit

te përdorimit nga kartel-mbajtësit, është evidente edhe rritja e numrit të bizneseve mjaft serioze të cilat duan të ofrojnë shërbimet apo mallrat e tyre përmes kësaj platforme.

Tashmë në Kosovë ka kompani të specializuara në aspektin e teknologjisë informative dhe specifikisht për sektorin bankar. Këto kompani janë duke ofruar shërbime të ndryshme bankave dhe njëkohësisht duke ju lehtësuar përgatitjen e platformave edhe për pagesat digjitale. Mund të përmendim edhe Quipu SHPK e cila vepron në Kosovë për një kohë të gjatë. Kompani e specializuar dhe e certifikuar nga sistemet e pagesave VISA dhe MasterCard, duke ju ofruar bankave shërbime të specializuara për personalizim të kartelave, mirëmbajtje të platformave digjitale të pagesave etj.

Përveç këtyre përparësive të cekura më lartë, siguria e pagesave digjitale zëne një vend shumë të rëndësishëm si për klientin ashtu dhe atë që ofron shërbimin.

Natyrisht që sukcesi i një platforme apo kanali të biznesit, përveç nevojave të dyanshme, është i lidhur shumë me besueshmërinë dhe sigurinë e saj.

Janë dy nivele të sigurisë, këto të rëndësishme për të gjitha palët, si për bankën, klientin ashtu dhe për biznesin.

Siguria e sistemeve bankare dhe aplikacioneve përmes se cilave ofrohen shërbimet.

Bankat janë duke u kujdesur dhe kushtuar rëndësi të veçantë sigurisë së sistemeve, aplikacioneve dhe veglave të cilat i ofrojnë për pagesa elektronike/digjitale.

Janë investime të konsiderueshme të cilat bankat po bëjnë duke realizuar dhe kontrata me kompani të specializuara ndërkombëtare në këto lami. Përfshi dhe delegim të shërbimeve të veçanta të specializuara tek këto kompani.

